

**VENDIM**  
**Nr. 583, datë 10.9.2014**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME  
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI  
UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 82, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Arteve.

Lista me 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1 (një).

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Arsimit dhe Sportit, Universiteti i Arteve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

### 3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

| Institucioni qendror: Universiteti i Arteve     |                              |                |                                                      |                                                                      |                                                     |                                     |                                                 |                                            |                                                           |                                                                          |
|-------------------------------------------------|------------------------------|----------------|------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------------|--------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|
| Fusha e përdorimit të pronës: arsim universitar |                              |                |                                                      |                                                                      |                                                     |                                     |                                                 |                                            |                                                           |                                                                          |
| A                                               |                              |                | B                                                    |                                                                      |                                                     |                                     | C                                               |                                            |                                                           |                                                                          |
| Nr. Rend                                        | Zona kadas. indeksi i hartës | Nr. i pasurisë | Emërtesa e pronës Vendndodhja/ shtrirja gjeografike  | Komponentët përbërës të pronës                                       | Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës          | Përmasat e pronës në m <sup>2</sup> | Funksioni për të cilin përdoret prona           | Institucioni me përgjegjësi administrative | Institucioni/enti përdorues, Statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)                                   |
| 1                                               | 2                            | 3              | 4                                                    | 5                                                                    | 6                                                   | 7                                   | 8                                               | 9                                          | 10                                                        | 11                                                                       |
| 1                                               | 8270 TrS-11.12               | 4/104          | Universiteti i Arteve, Tiranë                        |                                                                      |                                                     | 13 936                              | Arsim universitar                               | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesa të shkallëzuara Sipërfaqe totale ndërtimi 13 870 m <sup>2</sup> |
|                                                 |                              |                | Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”; Sheshi “Nënë Tereza” | Truall funksional rreth ndërtesave                                   | Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Sheshi “Nënë Tereza” | 5 488                               | Truall                                          | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     |                                                                          |
|                                                 |                              |                |                                                      | <b>Ndërtesa A</b> Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Salla e Koncerteve | “                                                   | 1 630                               | Administratë, ambiente mësimi, sallë koncertesh | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë e shkallëzuar në 2,3 dhe 5 kate                                 |
|                                                 |                              |                |                                                      | <b>Ndërtesa B</b> Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik      | “                                                   | 636                                 | Aktivitet arsimor                               | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë në 2 dhe 3 kate                                                 |
|                                                 |                              |                |                                                      | <b>Ndërtesa C</b> Fakulteti i Artit Skenik, Biblioteka               | “                                                   | 502                                 | Aktivitet arsimor                               | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë 2 kate                                                          |
| 1                                               |                              |                |                                                      | <b>Ndërtesa D</b> Fakulteti i Artit Skenik                           | Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Sheshi “Nënë Tereza” | 479                                 | Administratë dhe aktivitet arsimor              | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë 2 kate                                                          |
|                                                 |                              |                |                                                      | <b>Ndërtesa E</b> Fakulteti i Arteve të Bukura                       | “                                                   | 1 178                               | Administratë dhe aktivitet arsimor              | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë 2 dhe 3 kate                                                    |
|                                                 |                              |                |                                                      | <b>Ndërtesa F</b> Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik      | “                                                   | 575                                 | Aktivitet arsimor                               | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë 3 kate                                                          |
|                                                 |                              |                |                                                      | <b>Objekti G</b> Teatri Veror                                        | “                                                   | 490                                 | Aktivitet kulturor                              | Universiteti i Arteve                      | Universiteti i Arteve                                     | Ndërtesë 1 kat, pa mbulesë, Ndërtim dhuratë nga një donator              |